



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __.__.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare “5
Dëshmorët+kopësht,Suk1,ambjete sportive dhe ndërtim i palestrës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi:45210000-2;Punime ndërtimi për palestra:4521222-8; Punime ndërtimi për kopshte fëmijësh:45214100-1;

VLERA E FONDIT LIMIT: 78 583 225(shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqindë e tetëdhjetë e tre mijë e dyqindë e njëzetë e pesë)lekë pa tvsh

Argumentimi i fondit limit:Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, shoqëria për llogaritjen e çmime është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631,datë 26.10.2018 ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA ROSKOVEC ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;

2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 dhe 2 te DST).

3. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

4. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kritere janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjësinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të balanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar

dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar të kontratës që po prokurohet konkretisht:
78 583 225(shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqindë e tetëdhjetë e tre mijë e dyqindë e njëzetë e pesë)lekë pa tvsh (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 ne zbatim të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).
Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit

argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3.1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **jo me te vogel se 39 000 000** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë **jo me te vogel** se sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **157 000 000** (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.3.2. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
 - Faturë tatimore
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
- Fatura tatimore perkatese.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit te kontrates qe prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2.Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP– 1 **A** Punime gjermimi në tokë.
- NP– 2 **A** Ndërtime civile dhe industriale.
- NP- 3 **A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NP– 4 **A** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pistaeroportuale.
- NS– 2 **A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- NS- 4 **A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS– 12 **A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- NS– 13 **A** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- .
- NS– 14 **A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret

dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e	Përshkrimi i	Zërat e punimeve që parashikohen të	Niveli i	Vlera e punimeve në
kërkuar	kategorisë sipas legjislacionit të fushës	kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	kategorinë përkatëse
NP– 1 A Punime gjërmimi tokë. në	Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloji mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore..		Niveli A	
NP– 2 A Ndërtime civile dhe industriale.	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazërma ushtrie, teatro,		Niveli A	

	stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.			
• NP- 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.		Niveli A	
NP– 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të		Niveli A	

	nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.			
NS- 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.		Niveli A	
NS- 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dymëve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.		Niveli A	

• NS– 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi		Niveli A	
• NS– 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.	Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.		Niveli A	
• NS– 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.		Niveli A	

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.3.3. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punetore minimalisht 40 (dyzete) personave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklaroj disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Shtojca 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

a. Vertetim të leshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor 2022 - Korrik 2022**,.

b. Listepagesat e punonjësve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2022 - Korrik 2022**,.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues për pikat 2.3.3/a dhe 2.3.3/b

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **Qershor 2022 - Korrik 2022**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **te paktën 40 (dyzete) personave** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e

punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kater elementet e struktures së kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 15% të kostos.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për inxhinieret e mesipër.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Në preventivin e Punimeve ka zëra pune si: Gërmim dheu, Gërmim dheu për shtyllat dhe pusetat ndërtim ure, mbrojtje e perroit; si dhe zëra të tjerë të cilët shtrojnë domosdoshmërinë dhe nevojën për prezencën e inxhinierëve të kërkuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Teknik ndërtimi 1 (një)
- Murator 2 (dy)
- Hidraulik 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)

- Mekanik 1 (nje)
- Elektracist 1 (nje)
- Pllakashtures 2 (dy)
- Saldator 1 (nje)
- Arkitekt 1 (nje)

Për punonjesit e mësipërm të paraqiten kontratat e punes te vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat/diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara, për kurset e ofruara,

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar.

- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	-------------------------------------	---	------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar sipas pikës 2.3.3, (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmive të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.3.6. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes te specializuar/kualifikuar si me poshte:

- 4(tre) - Shofere**
4(tre) -Manovrator

Per manovratorët e mjeteve te renda si me siper te paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimin per makinerite e renda sipas profesionit perkates dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Per shoferet te paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimin dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar. ***Në rastin kur punonjësit Manovrator ose shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Manovratorët jane percaktuar me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

2.3.7 Operatori Ekonomik, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes 12- 15 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
2	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
3	Eskavator 9- 11 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
4	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
5	betoforma	Ne pronesi ose me qera	m 2	500
6	Autobot Uji	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
7	Autopomp betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
8	Rrul ngjeshes	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
9	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qera	Copë	4
10	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 Ton	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
11	Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5- 5 Ton	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
12	Kamion me vinc	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
13	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
14	betoniere	Ne pronesi ose me qera	Copë	4
15	AUTOMJET ME KOSH PER PUNIMET NE LARTESI	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
16	MIXER RROTULLUES PER	Ne pronesi ose me qera	Copë	1

	STABILIZIMIN E SHITESVE TE RRUGES			
17	MAKINERI PER PRERJE PLLAKASH	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
18	TRANXHE HEKURI	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
19	NIVELUES LAZER	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
20	SKELERI	Ne pronesi ose me qera	m 2	2500
21	VEGLA PUNE PER STAMPAT E BETONIT,VEGLA PER MURATORET FORMEDHENESIT PUNUESIT E CIMENTOS	Ne pronesi ose me qera	Copë	25
22	STAMPA BETONI	Ne pronesi ose me qera	Copë	40
23	PJASTER VIBRUES	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
24	SALDATRICE	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
25	BANGO HEKURI	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
26	DEPOZITA UJI	Ne pronesi ose me qera	Copë	2

- Kokore minimumi 40 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:

- certifikatën e pronësisë;
- leja e qarkullimit;
- certifikatën e kontrollit teknik;
- siguracionin;
- leja e transportit që leshohet nga njësia vendore
- fotot përkatëse ku të duket qartësisht targa dhe lloji i mjetit

b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e kohezgjatjes së objektit deri në përfundimin e plotë të punimeve.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

d) Mjetet dhe makinerit nuk duhet të jenë të angazhuar në objekte të tjera, vertetuar kjo me deklaratë të OE.

